



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 312

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS “SEBASTIA” DHE SHOQATËS PËR KULTURË
DEMOKRATIKE, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën me:

KËRKUES: 1. Shoqata “Sebastia”, me seli në Laç, Kurbin, Lagjja nr. 4, Laç
2. Shoqata për Kulturë Demokratike, me seli në Tiranë

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi për vëzhgues, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”

Data: 12.4.2023 Nr: 312
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “Sebastia” dhe Shoqatës për Kulturë Demokratike, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

V Ë R E J:

Shoqata "Sebastia" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 3 (tre) vëzhgues afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Shoqata "Sebastia" është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Shoqata për Kulturë Demokratike i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 34 (tridhjetë e katër) vëzhgues afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 e Kodit Zgjedhor. Shoqata për Kulturë Demokratike është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediae", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër të Shoqatës Sebastia, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 34 (tridhjetë e katër) vëzhguesve afatgjatë të Shoqatës për Kulturë Demokratike, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI